

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “Digi Games” sh.p.k.

Sot, me date 15 Maj 2024, une i neneshkruari:

- Z. Migen Stefani, Shtetas Shqiptar, lindur ne Maliq, Korce me 03.08.1982 me atesi Z. Anesti, banues ne Rr. Abaz Ermenji, Nd. 38, H. 4, Kashar, Yzberisht, Tirane, mbajtes i dokumentit te identitetit me numer personal I20803133F, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- Z. Gerhard Gjonaj, Shtetas Amerikan Lindur ne Tirane me 09.03.1983 me atesi Z. Edmond, Banues ne 51 Midfield Dr, Unit 16, Waterbury, CT 06705, USA, mbajtes i pashaportes me numer 592507394, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) kemi vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “Digi Games” sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte “Digi Games” sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: “Rr. Abaz Ermenji, Nd. 38, H. 4, Kashar, Yzberisht, Tirane”. Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

Panelet e komandimit te lojrave, video dhe makinat, artikujt per parqe lojrash, per lojrat e tavolines apo dhomes, perfshire lojrat me pineska, bilardot, tavolina speciale per lojrat e kazinose dhe pajisjet automatike te lojrave me birila. Artikujt dhe pjeset plotesuese per bilardo te te gjithë tipeve. Lojra te tjera qe operojne me monedha, kartmonedha, karta bankare, bono ose menyra te tjera pagese, te ndryshme per pajisjet automatike te lojrave me birila (bowling). Lojrat me ekran. Lojrat e tjera. Letrat e bizhozit. Panelet e komandimit te lojrave video dhe makinat. Kompletet elektrike te garave te makinave, qe kane karakterin e lojrave konkurruese.

Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 10 000 (dhjete mije) leke dhe i ndare ne 2 pjese (kuota) me vlere nomiale 10 000 (dhjete mije) leke.

Kapitali zoterohet nga ortakuet e shoqerise si me poshte:

-Z. Migen Stefani, i cili zoteron 1 kuote te Shoqerise ose 5 000 (pese mije) leke qe perfaqesojne 50 % te kapitalit te Shoqerise.

-Z. Gerhard Gjonaj i cili zoteron 1 kuote te Shoqerise ose 5 000 (pese mije) leke qe perfaqesojne 50 % te kapitalit te Shoqerise.

Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin të rrisin kapitalin e Shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë. Detyrimet e ortakëve të shoqërisë kundrejt Shoqërisë do të mbulohet vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tyre.

Neni 6

Shoqëria vepron nën rregjimin e pronës private dhe merr përsipër vetes të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore.

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtme:

-Asambleja e Përgjithshme;

-Administratori;

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme si dhe të administratorit të Shoqërisë janë të parashkruara në Statutin e Shoqërisë.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretet, e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i shoqërisë.

Neni 8

Mardhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që ta respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demet që shkaktojnë kësaj Shoqërie me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9

Në rast se Shoqëria do të mbyllë aktivitetin e saj për çdo lloj arsye, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të Shoqërisë, përcakton mënyrën e likuidimit, emeron një ose më tepër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e Shoqërisë i besohet një eksperti kontabel. Ky ekspert do të emërohet dhe qëndrojnë në detyrë sipas parashikimeve që bën ligji për ekspertet dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Përgjithshme cakton edhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

Neni 11

Viti financiar fillon në 1 Janar dhe mbaron në 31 dhjetor të secilit vit. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilancëve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimit. Pas analizimit të ceshtjeve të mesipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do të kalojnë ortakëve të Shoqërisë.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.


Për sa është shprehur në këtë Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar).

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

"Digi Games" sh.p.k.


Emer Mbiemer Nenshkrimi


Emer Mbiemer Nenshkrimi